



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
HANI I ELEZIT



Datë: 21.08.2020

09/Nr. 5748/2020

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA HANI I ELEZIT, përfaqësuar nga **Xhevdet Bushi, MSc. Shef i zyrës së Prokurimit** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"ATC COM," SH.P.K. SH.P.K. të cilën e përfaqëson **Arben MURSELI** me Numer unik identifikues: **810198780** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për: **"Ndertimi i mureve mbrojtëse"**

me numër Identifikues: **KKHE-20-018-521**; Nr. prokurimi sipas sistemit: **659-20-3347-5-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

"Ndertimi i mureve mbrojtëse" – financohet nga Komuna e Hanit të Elezit

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punimeve duhet të jetë: **31,629.90 €** dhe me fjalë (Tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e nent euro e /90 cent)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 - Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **SHQIPE**¹ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet BUSHI, MSc
Pozita:	Shef i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	21.08.2020
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Aben MURSELI
Pozita:	Përfaqësuese e autorizuar
Nënshkrimi:	
Data:	21.08.2020
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Gjuha e përdorur do të jetë <i>[SHQIPE]</i> .
	2.2	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vleres se kontrates</i>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[Sipas Ligjeve ne fuqi]</i>; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[Sipas Ligjeve ne fuqi]</i>; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[Sipas Ligjeve ne fuqi]</i>; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>Sipas Ligjeve ne fuqi</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[Sipas Ligjeve ne fuqi]</i>; - <i>Te gjitha demet qe ndodhin bien ne pergjegjesi te kontraktuesit dhe eshte pergjegjesi e Kontraktuesit qe per cdo rast qe ndodh qofte deme materiale, fizike apo fatale bien ne pergjegjesi te kontraktuesit sipas KPK-së dhe Ligjeve ne Fuqi.</i> - <i>(Gjykatat jane kompetente per kete çështje)</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <i>[5]</i> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Programi	12.1	Periudha për Programin e azhurnuar është <i>[5]</i> ditë
	12.2	Data e fillimit do të jetë <i>5 dite pas nenshkrimit te kontrates</i>
Fillimi i punëve	17.1	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>60]</i> ditë.
	17.2	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.20% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</i>

		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Regjistri i punës	20.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës
Inspektimi dhe testimi	22.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.20% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Parapagimi	26.1	Nuk aplikohet
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [N/A mbajtje e parave, pos sigurim i kerkuar nga punekryesi per periudhen 12 muaj nga data e pranimit]
Shkaqet për kompensim	30.1	Shuma e parave të mbajtura është: Nuk Aplikohet (vetem sigurimi i ekzekutimit aplikohet) Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë” -----
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Jo me shume se 5 dite Kontraktuesi duhet ti evitoj defektet
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Periudha garantuese e defekteve është (sipas gjendjes faktike ne terren e percaktuar nga komisioni komunal)
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Me marreveshje ne mes te AK dhe OE, ose Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë ose Ne te kunderten do te pasoj padia ne Gjykatën kompetente (do te llogariten te gjitha demet)
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Gjykata themelore Prishtine – Departamenti per Çeshtje ekonomike